

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

MATERIALE PASTRIMI

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Peceta higjenike një-përdorimshme – Kodi: 33711430-0,

Peceta letre higjenike -Kodi: 33770000-8,

Detergjentë -Kodi: 39831200-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

2 083 333 (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lek pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës I vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin perbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83, i Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Kopje të vërtetuara të bilanceve të tre viteve të fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",

i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkojnë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit prej **40% të fondit limit**, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit. Per kete te paraqiten:

-Per kontratat me Institucionet shtetore te paraqiten kontratat e lidhura te shoqëruara me vërtetime realizimi, dhe

-Furnizimet me subjekte private duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore te shitjes te konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku te shenohen malli, shumat dhe sasite.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, osedyfishi i

- Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te paraqesim vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitet 2021-2022.

Deklarate nga operatori ekonomik pjesemarres se i ka shlyer te gjitha detyrimet vendore per keto vite.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka.

2.Një punësim mesatar I të paktën 6 personave për periudhën dhjetor 2022- Shkurt 2023 te vërtetuar me;

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri I punonjësve për secilin muaj; per periudhën perkatese

-List pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore.

-Minimalisht 2 shofera, 1 sanitare te deklaruar ne listepagesa me kodin perkates.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, me perjashtim te listepageses e cila duhet te paraqitet elektronikisht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 5/c dhe 5/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Pasi institucioni yne duhet te sigurohet se cdo operator ushtron aktivitetin konform te gjitha dispozitave ligjor ne fuqi dhe eshte korrekt me pagimin e cdo detyrimi financiar qe ka dhe te kete te punesuar keto specialiste te domosdoshem per te kryer furnizimin e mallrave.

3.Subjektet ofertues duhet te ushtrojne aktivitetin e tyre ne qytetin ku ndodhet institucioni e vertetuar me dokumentacionin perkates tekniko - ligjor (ambjente ne pronesi apo me qera) (ose te kene pike kontakti ne rrethin e Shkodres si adrese te dyte , te vertetuar me dokumentacion perkates tekniko - ligjor, i regjistruar ne qkr si adrese e dyte e ushtrimit te aktivitetit dhe i pajisur

me vertetim debie nga FSHU) pasi specifikat e ketij institucioni kerkojne qe furnizimi te garantohet ne cdo dite dhe cdo ore te kerkuar sipas kerkesave te AK deri me date 15.12.2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se ne baze te vecantise qe paraqet ky prokurim. Furnizimi do jete periodik dhe me kerkesa ditore, prandaj vleresohet qe cdo subjekt pjesemarres dhe eventualisht fitues te kete nje pike kontakti ne rrethin e Shkodres ne menyre qe te mos kete probleme gjate zbatimit te kontrates.

4.Deri ditën e hapjes se ofertave operatorët ekonomik ofertues duhet te bejne paraqitjen e mostrave prane protokollit te institucionit per te gjithë artikujt qe jane pjese perberese e preventivit. Mostrat duhet te jene ne perputhje me specifikimet teknike, sipas te gjitha percaktimeve te bera nga AK. Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja me specifikimet teknike perben kusht per skualifikim. Kostoja e paraqitjes se mostrave mbulohet nga vete operatori ekonomik.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata I plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar sidhekonfidencialitetin përpjesë marrjennë proces. Mostrat i thehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontratanë fjalët e mosjetë objektish qyrtimit administrativapogjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat I kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimi të përfundimtar të anulimit.

5.Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën dy mjete me ngarkesë deri 1ton, per te bere te mundur levrimin e produkteve të ofertuara në njësitë e AK. Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me:

- *Kontrate te lidhur perpara Noterit,*
- *Certifikatat e pronesise,*
- *lejet e qarkullimit,*
- *kontrolli teknik,*
- *taksat e paguara,*
- *siguracioni,*

Për mjetin në pronësi te paraqiten:

- *Certifikatat e pronesise,*
- *lejet e qarkullimit,*
- *kontrolli teknik,*
- *taksat e paguara,*
- *siguracioni.*
-

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti vlereson se është e domosdoshme posedimi i dy mjeteve për të bërë transportin nga pika e shpërndarjes deri tek magazina e institucionit.

6. Shoqëria duhet të paraqes Certifikaten ISO 9001:2015, Certifikate ISO 45001:2018 (Ekuivalente), lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se çdo subjekt pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar për të garntuar edhe cilësinë e produkteve objekt prokurimi

7. Mallrat duhet të jenë origjinal dhe të shoqëruara me certifikate cilësie dhe origjine në momentin e dorëzimit të tyre.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se çdo subjekt pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar për të garntuar edhe cilësinë e produkteve objekt prokurimi

8. Operatorët ekonomik duhet të paraqesim në SPE Certifikaten CE për të gjithë artikujt pjesë perberëse të preventivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor vlereson se cdo subjekt pjesemarres duhet te jete i certifikuar per te garntuar edhe cilesine e produkteve objekt prokurimi.

NJESIA E PROKURIMIT